

VENDIM
Nr. 59, datë 7.7.2014

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES TË SHOQËRISË “BISTRICA 3 ENERGY” SHPK
NGA HEC-et “BISTRICA 3” DHE “BISTRICA 4”**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 3, pika 1, germa “f”, të ligjit nr. 138/2013, datë 2.2.2013, “Për burimet e energjisë së rinovueshme”; nenit 9, pika 1, dhe pika 2, germa “a” të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Bistrica 3 Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC-et “Bistrica 3” dhe “Bistrica 4”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Bistrica 3 Energy” sh.p.k., është plotësuar konform Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”;

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të kualifikojë impiantin prodhues të shoqërisë “Bistrica 3 Energy” sh.p.k., për HEC-et “Bistrica 3” dhe “Bistrica 4”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti